

Studim Vjetor i Qendrës së Arbitrazhit





Publikim i Qendrës së Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë

© Qendra e Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, 2016

Të gjitha të drejtat e rezervuara. I gjithë materiali i përfshirë në këtë raport është pronë e Qendrës së Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë. Ky material mund të riprodhohet dhe mund të shfrytëzohet për qëllime jokomerciale të ndërlidhura me arbitrazhin komercial, vetëm nëse ky publikim citohet dhe identifikohet si burim i informacionit.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Qendrës së Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Përmbajtja

I.	<i>Tabela e akronimeve</i>	3
II.	HYRJE	4
III.	METODOLOGJIA	5
IV.	KORNIZA LIGJORE PËR ARBITRAZH	6
V.	PASQYRA E REZULTATEVE	7
VI.	DISKUTIM MBI REZULTATET	14
VII.	<i>Pyetësori</i>	17



Tabela e akronimeve

Akronimi	Përshkrimi
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimi Ndërkombëtar
Qendra e Arbitrazhit	Qendra e Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë
Ligji i Arbitrazhit	Ligji i Arbitrazhit i Kosovës Nr. 02/L-75
UNCITRAL	Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtë Ndërkombëtare Tregtare
Ligji Model i UNCITRAL	Ligji Model i UNCITRAL për Arbitrazhin Ndërkombëtar Komercial
Konventa e Nju Jorkut	Konventa Ndërkombëtare për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit 1958
ICSID	Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjes e Kontesteve në fushën e Investimeve
ICC	Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris

HYRJJE

Në dekadën e fundit, ndër sfidat e raportuara nga bizneset në vazhdimësi dhe në veçanti lidhur me zbatimin e kontratave, paraqitet funksionimi jo i kënaqshëm i gjykatave. Bazuar në rezultatet një hulumtimi mbi gjendjen e bizneseve në Kosovë, të realizuar në vitin 2014,¹ vetëm 5% të respondentëve janë deklaruar se sistemi gjyqësor është efikas, përderisa 38% e shohin si joefikas, në krahasim me 57% që e shohin si mesatarisht efikas. Në një situatë të tillë, dhe që para vitit 2011 me arsye mund të thuhet se ishte edhe më e rëndë, dhe duke vlerësuar nevojën e zgjerimit të tregut të shërbimeve ligjore në drejtim të ofrimit të alternativave për zgjidhjen e kontesteve, u investua në themelimin e arbitrazhit institucional, përderisa përpjekjet në vazhdimësi u mbështetën nga misioni i USAID në Kosovë.

Arbitrazhi është formë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatave, i cili bëhet i mundshëm me pajtimin e palëve me shkrim se çfardo dhe secila mosmarrëveshje e cila lind nga raporti i tyre kontraktual do të zgjidhet përmes një paneli të pavarur të arbitërve. Thënë shkurt, arbitrazhi është kontratë në mes të palëve, dhe legjitimiteti për një procedurë të tillë gjen bazë në Ligjin për Arbitrazhin.

Me fillim nga viti 2011, Qendra e Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë (fillimisht me emërtimin “Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve”) ofron shërbime të arbitrazhit. Shërbimet e arbitrazhit janë shërbime lidhur me administrimin e rastit, përderisa shqyrtimi, rrjedhimisht marrja e vendimeve bëhet nga arbitrit, secili prej tyre i zgjedhur nga palët në rastin përkatës. Kompetenca e arbitërve rrjedh nga kontrata në mes të palëve, dhe lënë anash rastet kur pala nuk bashkëpunon në procedurë, vet emërimet e tyre rrjedhin nga palët. Shërbimet e Qendrës së Arbitrazhit nuk janë të kufizuara vetëm për anëtarët e Odës Amerikane, dhe u ofrohen të gjitha palëve të interesuara, qoftë kompani vendore apo të huaja.

Megjithë kritikën e vazhdueshme ndaj gjyqësorit, arbitrazhi mbetet pak i përdorur nga bizneset. Në mes tjerash, barrierat në përdorimin e arbitrazhit janë raportuar të jenë mungesa e informatave lidhur me këtë mekanizëm; shqetësimi lidhur me mungesën e një shkalle të ankimimit; si dhe hezitimi i bizneseve që të jenë nismëtar të përdorimit të këtij mekanizmi, ende duke e konsideruar si periudhë testuese.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë lidhur me barrierat e lartpërmendura, përcëptimin e bizneseve lidhur me funksionimin e gjykatave si dhe ndikimin e këtij përcëptimi në pranimin e arbitrazhit si metodë të pranueshme për zgjidhje të kontesteve, Qendra e Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane ka zhvilluar këtë studim.

¹ State of Business in Kosovo: Challenges and opportunities for doing business

METODOLOGJIA

Me qëllim të pasjes së një pasqyre të përcëtimeve të bizneseve lidhur me arbitrazhin, dhe nivelin e tyre të njohjes së specifikave të kësaj procedure, Qendra e Arbitrazhit ka realizuar intervista me 42 biznese. Ky grup biznesesh është mostër e rastësishme. Grafi i mëposhtëm jep një pasqyrë të profileve të respondentëve.




Fig. 1: Profili i respondentëve

Shënim 1: Rezultatet e raportuara në këtë studim duhet të konsiderohen vetëm si opinione të pjesëmarrësve në studim dhe nuk duhet të gjeneralizohen në mënyrë që të përfaqësojnë opinionet e bizneseve në përgjithësi.


Shënim 2: Pyetësori i plotë i këtij studimi, për referencë, është i bashkangjitur në fund të këtij studimi.

KORNIZA LIGJORE PËR ARBITRAZH

Deri në aprovimin e Ligjit për Arbitrazhin në vitin 2007, procedura e arbitrazhit rregullohej përmes dispozitave të veçanta dhe brenda kornizave të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Ligji në formën e tij aktuale adreson të gjitha fazat e procedurës së arbitrazhit, përfshirë fazën pas lëshimit të vendimit të arbitrazhit, rrjedhimisht atë të njohjes dhe zbatimit të vendimeve.

Ligji përmban dispozita për arbitrazhin ndërkombëtar si dhe atë vendor, përderisa premabula e tij zotohet që të respektoj dhe të siguroj uniformitetin e dispozitave të tij me parimet e përgjithshme ndërkombëtare të arbitrazhit. Hartuesit e ligjit kanë marrë në konsideratë një numër ligjesh të huaja të arbitrazhit, siç është ai Gjerman dhe Austriak.

Veç kësaj, edhe pse me disa ndryshime, ligji si bazë ka Ligjin Model i UNCITRAL (verzioni i vitit 1985), poashtu edhe të Konventës së Nju Jorkut për Vendimet e Huaja të Arbitrazhit. Duke përqafuar këto dy instrumente, hartuesit kanë siguruar se ligji është një ligj modern me elemente në përkrahje të arbitrazhit dhe me intervenim minimal të gjyqësorit.



PASQYRA E REZULTATEVE

a. Lidhur me mosmarrëveshjet në përgjithësi

Pyetjet në këtë pjesë reflektojnë mbi mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga respondentët në të kaluarën, si dhe opinionin e respondentëve të cilët janë deklaruar se nuk kanë pasur ndonjëherë mosmarrëveshje.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë lidhur me trendin e kontesteve komerciale, grafi i mëposhtëm jep një pasqyrë të numrit të mosmarrëveshjeve që respondentët janë ballafaquar brenda një viti. Lidhur me këtë, 33% të të intervistuarve u deklaruan se brenda një viti nuk ballafaqohen me ndonjë mosmarrëveshje, 43% u deklaruan se kanë mesatarisht 1 deri në 5 mosmarrëveshje në vit, ndërsa vetëm 7% u deklaruan për 10 apo më shumë mosmarrëveshje në vit. Nga ky numër i mosmarrëveshjeve, më shumë se 50% prej tyre rrjedhin nga shkelja e obligimeve të ndryshme kontraktuale, dhe realizimi i punëve me të meta.




Fig. 2: Natyrë e mosmarrëveshjeve

Lidhur me mënyrën e zgjidhjes së këtyre kontesteve, respektivisht nëse kanë zgjedhur gjykatat apo arbitrazhin, 16 prej respondentëve del se kanë zgjedhur gjykatat, ndërsa vetëm 5 u deklaruan se kanë zgjedhur arbitrazhin. Pavarësisht se pyetësi ka ofruar vetëm këto dy alternativa, 5 nga respondentët komentuan se nuk kanë zgjedhur asnjërin nga të dyja, një prej tyre u deklarua se ka zgjedhur arbitrazhin ndërkombëtar, ndërsa dy të tjerë mundësinë e përmbarimit privat.

Kur respondentët të cilët deklaruan se kontestet e tyre i kanë referuar për zgjedhje pranë gjykatës janë pyetur nëse janë të kënaqur me funksionimin/punën e gjykatave, asnjë brenda këtij grupi nuk është deklaruar si mjaft i kënaqur. Në anën tjetër, 44% prej tyre u deklaruar si të pakënaqur, përderisa 56% prej tyre janë deklaruar mesatarisht të kënaqur.




Fig. 3: Niveli i kënaqshmërisë me punën e gjykatave

Problemi më i shpeshtë sa i përket punës së gjykatave raportohet të jetë mungesa e eksertizës së gjyqtarëve në fusha më specifike (26%), përderisa ndikimet nga jashtë në procedurë gjyqësore (17%) shihen të jenë në vendin e dytë në rradhën e problemeve të raportuara. Kur respondentët janë pyetur se cilat ishin arsyet (apo përparësitë) e përdorimit të gjykatës në vend të arbitrazhit për zgjidhjen e kontesteve, pjesa më e madhe u deklaruan se nuk janë të informuar lidhur me arbitrazhin dhe që hezitojnë të përdorin një metodë e tillë, duke qenë se nuk është e njohur për ta. Në mesin e arsyeve të raportuara ishte fakti se rastet nuk kishin element ndërkombëtar, prandaj edhe kostoja e arbitrazhit për raste lokale u cilësua si e lartë.

Respondentët të cilët kanë zgjedhur arbitrazhin në vend të gjykatave kanë qenë të ndarë në vlerësimet e tyre ndaj procedurës së arbitrazhit, gjysma e tyre duke u deklaruar si mjaft të kënaqur me procedurën, ndërsa gjysma tjetër si të pakënaqur. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se asnjë prej respondentëve të këtij grupi nuk kanë pasur cilësinë e palës në rasteve e administruara nga Qendra e Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane – dhe se pyetja i është referuar në veçanti Qendrës së Arbitrazhit. Prandaj edhe dy pyetjet e tjera lidhur me arbitrazhin pranë Qendrës së Arbitrazhit nuk paraqesin rezultat relevant dhe të besueshëm për qëllimet e hulumtimit.

Respondentët të cilët nuk raportuan mosmarrëveshje përgjatë vitit të fundit u deklaruan të jenë për 67% në përkrahje të arbitrazhit, përderisa pjesa tjetër u deklarua se do të zgjedhte gjykatat. Veç këtyre, një përgjigje shtesë konsiston në atë se arbitrazhi do të zgjidhej vetëm nëse rastet, rrjedhimisht kontestet, kanë element ndërkombëtar. Grafi i mëposhtëm pasqyron perceptimet e respondentëve lidhur me problemet në punën dhe funksionimin e gjykatave në Kosovë:




Fig. 4: Përceptimet e kompanive të cilat nuk kanë pasur konteste lidhur me punën e gjykatave

Përshtypjet e tjera lidhur me punën e gjykatave u deklaruan edhe niveli i lartë i korrupsionit, zvarritja e qëllimshme e procedurës, humbja e provave dhe shkresave nga zyrtarët e gjykatës, teknologji joefektive, moskomunikim shkresor dhe elektronik i kënaqshëm, shkelja e afateve ligjore dhe gjyqësore, dhe mungesa e njohurive në fusha specifike e posaçërisht në lëmi komerciale nga gjyqtarët e Departamentit për Çështje Ekonomike brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kur kjo kategori e respondentëve është pyetur lidhur me atë se për cilat arsye do të përdorimit të gjykatës në vend të arbitrazhit ata kanë dhënë arsyet si në vijim: kostoja më e ulët, arbitrazhi trajton më tepër rastet më komplekse, frika e mungesës së shkallës së apelit, fakti se vendimi i gjykatës është më fuqiplotë dhe lejon që të përdoren të gjitha shkallët e gjyqësorit, se gjykatën do ta përdorin vetëm në rastet vendore duke qenë se kompanitë vendore nuk kanë përvojë në arbitrazh, dhe së fundi fakti, se kanë më shumë përvojë me gjykata.

Në anën tjetër, respondentët thanë se disa nga arsyet në përkrahje të përdorimit të arbitrazhit në vend të gjykatës janë: shpejtësia e përfundimit të rastit; fakti se arbitrazhi është më profesional dhe më adekuat, mbrohet interesat dhe kompania ka qasje më të lehtë; koncentrim më i madh në shqyrtim të lëndës dhe procedurë më e thjeshtë, efikasitet më i madh në krahasim me gjykata dhe procedurë më afatshkurtë; profesionalizmi dhe mosndikimi i jashtëm; në veçanti mundësia e emërimit në cilësinë e arbitrit individin i cili ka përgatitje jo domosdoshmërisht juridike por ka cilësinë e ekspertit të lëmisë; dhe ruajtja e imazhit duke konsideruar se procedura është konfidenciale.

Grafi i mëposhtëm konfirmon se konfidencialiteti, në raport me parimin e publicitetit në procedurën para gjykatave, paraqet ndër përparësitë kryesore të arbitrazhit:




Fig. 5: Rëndësia e konfidencialitet për bizneset

b. Informimi lidhur me arbitrazhin

Pjesa e dytë e pyetësorit adreson nivelin e informimit të respondentëve lidhur me arbitrazhin. Të gjitha pyetjet e kësaj pjese i janë drejtuar të gjithë respondentëve. Lidhur me këtë, përdorin 40% të të intervistuarve janë deklaruar se kanë njohuri mbi arbitrazhin, 45% janë deklaruar se janë pak të informuar, përdorin vetëm 14% u deklaruan se kanë mungesë të njohurive për këtë mekanizëm të zgjidhjes së kontesteve. Nga raportimet e bëra del se burim i informatave mbi arbitrazhin ishte kryesisht Odën Ekonomike Amerikane, mediat, studimet, trajnimet, Oda e Avokatëve të Kosovës, përvoja paraprake me arbitrazh ndërkombëtar, si dhe informatat nga partnerët e jashtëm të biznesit.

Respondentët të cilët kishin pak apo mungesë të tërësishme të informatave theksuan se kjo vjen për arsye të mosballafaqimit me ndonjë problem – rrjedhimisht edhe mosinteresimit për hulumtim të mëtejshëm për specifikat e këtij mekanizmi, si dhe për shkak se në Kosovë si praktikë ka ardhur me vonë.

Nga rezultati më lartë shihet se sektori i bizneseve mënyrën e zgjidhjes së kontesteve ende nuk e shoh si strategji e të bërit biznes. Lidhur me këtë, nga 83% të cilët kanë deklaruar se përdorin kontratat e shkruara në të gjitha rastet, 12% vetëm në marrëveshjet e rëndësishme në biznes, dhe 5% që përdorin kryesisht marrëveshje të pashkruara, vetëm 51% janë deklaruar se biznesi të cilin e përfaqësojnë përdorin një politikë formale të brendshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Lidhur me këtë:




Fig. 6: Zbatimi i politikave të brendshme lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Respondentët janë pyetur nëse në kontratat e tyre tashmë përdorin klauzolat e arbitrazhit (alternativisht ato të ndërmjetësimi), dhe lidhur me këtë del se:




Fig. 7: Përdorimi i klauzolave në kontrata

Klauzolat për zgjidhjen e kontesteve paraqesin pozicione negociuese kontraktuale, dhe nëse si të tilla janë pjesë e politikave formale të kompanive, insistimi lidhur me këto pozicione është i domosdoshëm. Përgjigjet reflektojnë se 46% të respondentëve këmbëngulin në përfshirjen e klauzolave, 28% nuk bëjnë një gjë të tillë, ndërsa pjesa e mbetur prej 26% u deklarua si e pasigurtë.

Për periudhën 2012-2016 respondentët kanë deklaruar se kanë përfshirë këtë numër të klauzolave:




Fig. 8: Numri i klauzolave të arbitrazhit të përfshira gjatë vitit 2012-2016

Duke qenë të vetdijsëm se arbitrazhi paraqet mekanizëm të ri në tregun për shërbime ligjore, respondentët janë kërkuar të deklarohen lidhur me atë se kush merr vendim për përfshijen e klauzolave të tilla.

Sipas grafit në vijim vendimet lidhur me përfshirjen e klauzolave mirren nga:




Fig. 9: Vendimarrja lidhur me përfshirjen e klauzolave të arbitrazhit

c. Çështje të tjera

Pjesa e fundit e pyetësorit përmbanë pyetje të tjera të ndërlidhura me arbitrazhin. Në pyetjen nëse të intervistuarit mendojnë se Qendra e Arbitrazhit duhet të ofroj një shkallë të ankesës ndaj vendimeve të tribunaleve të arbitrazhit, 83% e të intervistuarve janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa 17% nuk kanë përkrahur një ide të tillë. Më tutje, respondentët janë pyetur lidhur me përceptimin e tyre sa i përket kostos së arbitrazhit, përkatësisht nëse mendojnë se kjo procedurë është më e kushtueshme se procedura gjyqësore. Përgjigjet ishin këto:




Fig. 10: Përceptimi i respondentëve lidhur me koston e procedurës së arbitrazhit

Në pjesën e dytë të pyetësorit poashtu ka gjetur vend një pyetje e ndërlidhur me arbitrazhin. Duke parë diskutimet e lidhur me praninë e klauzolave në kontratat e prokurimit publik, në veçanti në ato me vlera më të mëdha, nga respondentët u kërkuar të deklarohen nëse do të preferonin përfshirjen e arbitrazhit në kontratat publike. Grafi në vijim reflekton mbi disponimin e tyre lidhur me këtë mundësi:




Fig. 11: Arbitrazhi në kontratat e punëve publike

Krejt në fund, respondentët janë pyetur nëse dhe sa kanë besim në punën e Qendrës së Arbitrazhit të Odës Ekonomike Amerikane. Një përqindje prej 51% kanë deklaruar se kanë besim në punën e Qendrës, ndaj dhe figura më poshtë jep një pasqyrë të këtij perceptimi:




Fig. 12: Besueshmëria në punën e Qendrës së Arbitrazhit

DISKUTIM MBI REZULTATET

Një gjetje inkurajuese e këtij studimi mund të filloj me atë se më shumë se gjysma e bizneseve pjesë e këtij studimi, si ato të cilat janë përballur me gjykata poashtu edhe ato të cilat nuk kanë pasur rast të tillë (67%), u deklaruan se në të ardhmen do të zgjedhin arbitrazhin në vend të procedurës gjyqësore. Ndër arsyet të cilat ndikojnë në një vendim të tillë u raportuan të jenë: zvarritja e qëllimshme e procedurës, humbja e provave dhe shkresave nga zyrtarët e gjykatës, teknologjia joefektive, moskomunikim shkresor dhe elektronik i kënaqshëm, shkelja e afateve ligjore dhe gjyqësore, si dhe mungesa e ekspertizës së gjyqtarëve në fusha specifike.

Në anën tjetër, problemet e lartpërmendura janë pikërisht avatantazhet të cilat i ofron procedura e arbitrazhit – komunikim efektiv shkresor, dhe elektronik, teknologji moderne e avancimit të raseve, procedurë e shpejtë, shqyrtim i rastit nga ekspert të fushës në varësi nga natyra e mosmarrëveshjes, dhe shumë të tjera.

Arbitrazhi, si alternativë jashtëgjyqësore, është thënë të ketë lindur në kohë të krizave, duke aluduar kështu në periudhën e defekteve në funksionimin e sistemit gjyqësor. Nëse marrim për bazë këtë tezë, dhe rezultatet e këtij studimi të cilat pasqyrojnë se asnjë kompani e cila është përballur me gjykata nuk është i kënaqur me funksionimin e tyre, atëherë detyrohemi të pranojmë se në një stagnim të tillë hapet mundësia e përzgjedhjes së alternativave të tjera jashtëgjyqësore.

Mungesa e ekspertizës së gjyqtarëve për çështjet komerciale ka rezultuar të jetë problemi kryesor në sistemin gjyqësor. Në anën tjetër, palët në arbitrazh kanë mundësinë e zgjedhjes nga një listë e gjatë e arbitërve, të cilët janë ekspert të fushave të ndryshme si dhe janë të trajnuar që procedurën e arbitrazhit t'a zhvillojnë në mënyrë efektive. Për më tepër, lista e arbitërve ofron edhe arbitër ndërkombëtar me renome, të cilët patjetër se janë zgjidhje më e mirë në rastet me element ndërkombëtar. Mungesa e ekspertizës së gjyqtarëve për çështjet komerciale, e përcjellur me faktor të tjerë ka ndikuar në krijim e një imazhi jo të mirë të sistemit gjyqësor. Prandaj edhe deklarimi i kompanive të cilat asnjëherë nuk janë përballur me gjykata, që kontestet e ardhshme t'i zgjedhin përmes arbitrazhit ka ardhur si rezultat i përshtypjeve të tyre se pranë gjykatave do të përballeshin me një procedurë të gjatë, me mundësi që procedura të ndikohet nga faktorë të jashtëm, si dhe me mungesë të ekspertizës së gjyqtarëve në çështje komerciale.

Gjendja aktuale tregon se shumica dërrmuese e mosmarrëveshjeve në të kaluarën dhe e atyre ekzistente u drejtohen për shqyrtim dhe zgjidhje gjykatave vendore, sistem të cilin palët tradicionalisht e kanë konsideruar si më të sigurtë. Përdorimi i arbitrazhit ende qëndron në nivel të ulët. Lidhur me këtë, një indikacion me rëndësi mbetet fakti se një pjesë e respondentëve në këtë hulumtim deklaruan se arbitrazhin e kanë përdorur apo synojnë t'a përdorin vetëm në kontratat me palë ndërkombëtare. Ky rezultat lë vend të besohet se kompanitë janë kryesisht më të hapura ndaj arbitrazhit jashtë shtetit, ndaj edhe në kontratat me element ndërkombëtar pajtohen mbi këtë procedurë. Megjithatë, njëra ndër arsyt kryesore reale për këtë është fakti se partnerët e huaj rrallëherë janë të gatshëm që subjektivitetin për zgjidhjen e kontesteve t'ia kalojnë një gjykate në territorin e së cilës është e themeluar dhe afarizon pala tjetër në kontratën përkatëse, dhe anasjelltas.

Për më tepër, në analizë të përceptimeve se arbitrazhi është në masë të vogël më i kushtueshëm se procedura gjyqësore (38%), është me rëndësi të theksohet se kostoja e procedurës së arbitrazhit në institucionet e arbitrazhit në pjesën e Evropës juglindore dhe asaj perëndimore është kryesisht më e lartë në raport me tarifaf aktuale të Qendrës së Arbitrazhit. Nga kjo del se palët duhet të njoftohen se në procedurën e arbitrazhit, edhe pse totali i shpenzimeve bëhet në fillim të procedurës, është pala humbëse ajo e cila merr përsipër të gjitha shpenzimet e procedurës pas lëshimit të vendimit final të arbitrazhit.

Argument mjaft prezent në disfavor të përzgjedhjes së arbitrazhit mbetet mungesa e procedurës së ankesës, dhe përceptimi se vendimi gjyqësor është më fuqiptotë në raport me vendimin e arbitrazhit. Edhe pse mekanizmi i apelit nëpër institucionet e arbitrazhit nuk është pothuajse fare prezent, me përjashtim të ICSID dhe ICC, dhe Qendra e Arbitrazhit nuk synon të themeloj një procedurë të tillë, rezulton se shumica e bizneseve do të donin që një shkallë e apelit të ishte në dispozicion për ta. Sidoqoftë, mënyra e funksionimit të këtij mekanizmit të arbitrazhit skajshmërisht amortizon nevojën e një shkalle të dytë për ankesa. Kjo për arsye se fleksibiliteti i procedurës së arbitrazhit në raport me qasjen e prerë dhe strikte të gjykatës, si dhe mundësia për ta prezantuar rastin ashtu siç është më e përshtatshme për palët, duke i shtuar edhe ekspertizën dhe koncentrimin e arbitërve një rast të vetëm përgjatë një periudhë kohore amortizon maksimalisht nevojën e një procedure të apelit.

Edhe situata për sa i përket nivelit të informimit të bizneseve mbetet ende e pakënaqshme. Targeti kryesor për fushatën e avokimit pro-arbitrazhit komercial patjetër se mbetet komuniteti ligjor, për faktin e padiskutueshëm se juristët janë ata të cilët njohin në detaje çështjet ligjore dhe janë ata të cilët luajnë rol kyç në draftimin e kontratave. Megjithatë, transaksionet biznesore dhe negociatat kontraktuale përbëjnë përgjegjësi të nivelit udhëheqës të kompanive, ku negociatat kontraktuale përfshinë edhe fuqinë që pala tjetër në kontratë t'i bindet propozimit për përfshirjen e klauzolave të arbitrazhit në kontrata. Kjo mbështetet edhe nga rezultatet e studimit, i cili reflekton se vendimin për përfshirjen e klauzolave të arbitrazhit mirret kryesisht nga drejtorët dhe kryeshefat ekzekutiv, duke lënë kështu stafin ligjor të dytin me rradhë në këtë cikël të vendimmarrjes. Prandaj dhe, përpjekjet për avokim, në masë të madhe janë duke u bërë në drejtim të udhëheqësve të bizneseve, duke qenë se vendimi për përfshirjen e klauzolave të arbitrazhit paraqet vendim biznesor, si pjesë e strategjive afatgjate të kompanive.

Në përputhje me rezultatet e studimit, shihet se kategoria e kompanive e cila ka mungesë të informatave mbi mekanizmin e arbitrazhit, është kryesisht kategori e cila ende nuk është përballur me probleme dhe mosmarrëveshje dhe qasjen në informata lidhur me arbitrazhin nuk e kanë konsideruar si hap të domosdoshëm. Rrjedhimisht, përzgjedhjen e metodës së zgjidhjes së kontesteve kjo kategori e ka rezervuar për periudhën e pas lindjes së një kontesti potencial, si një vendim i së ardhmes. Në teori, arbitrazhi mund të kontraktohet edhe në periudhën pas lindjes së mosmarrëveshjes. Megjithatë, në praktikë kjo ndodh rrallë, për të vetmen arsye se palët në kontest gjenden në pozicione të acaruar dhe arritja e pajtimit lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kontesteve është praktikisht e pamundshme. Në veçanti, pala e cila presupozohet të ketë shkelur obligimet kontraktuale do të rezistoj skajshmërisht pajtimin për arbitrazh, në dijeni se kjo procedurë është e shpejtë dhe me drojë të një vendimi në disfavor të saj. Kjo e dalë, shpërfaq edhe njëherë nevojën që vetdijësimi i bizneseve të shkoj në drejtim të asaj se vendimi lidhur me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të merr cilësinë e një vendimi strategjik. Poashtu, përderisa në shumicën e rasteve supozohet se juristët, respektivisht avokatët angazhohen vetëm në fazën pas lindjes së kontestit, preferohet që ky grup të jetë prezent edhe në periudhën e negocimit të kontratave, duke qenë se ekspertiza e tyre është e domosdoshme sidomos sa i përket draftimit dhe përmbajtjes së klauzolave. Shpeshherë shpenzimet e arbitrazhit, arsye e cila vazhdimisht insistohet si disavantazh i

arbitrazhit, mund të kontrollohen përmes draftimit të klauzolave, ashtu që të jenë të favorshme në raport me natyrën dhe vlerën e kontratave.



Pyetësori Vjetor i Qendrës së Arbitrazhit
Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
Korrik – Gusht 2016

Kompania:

Sektori:

Pozita e të intervistuarit:

Data: __/__/2016

Qëllimi i hulumtimit është:

1. Të vlerësoj përdorimin e arbitrazhit nga kompanitë në Kosovë dhe arsyet për përcaktimin e arbitrazhit si metodë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
2. Të vlerësojë njohuritë e kompanive në lidhje me arbitrazhin;
3. Të jap rekomandime se çfarë mund të bëhet për të promovuar arbitrazhin dhe përdorimin më të shpeshtë të këtij mekanizmi.

I. NË LIDHJE ME MOSMARRËVESHJET NË PËRGJITHËSI

1. Sa është numri i mosmarrëveshjeve që kompania juaj ballafaqohet brenda vitit?
 Asnjë
 1-5
 6-10
 Më shumë se 10.

(Nëse përgjigja juaj është “asnjë”, ju lutem shkoni tek pyetja numër 10).

2. Cila është natyra e mosmarrëveshjeve me të cilat kompania juaj është ballafaquar?
 Mosmarrëveshje kontraktuale
 Mosmarrëveshje financiare
 Punë me të meta
 Të tjera (specifiko)
3. Cilin mekanizëm për zgjidhje të kontesteve keni zgjedhur me rastin e ballafaqimit me mosmarrëveshje?
 Gjykatat vendore
 Arbitrazhin

(Nëse përgjigja juaj është “gjykatat vendore”, ju lutem përgjigjuni në pyetjet 4, 5 dhe 6. Nëse përgjigja juaj është “arbitrazhi”, ju lutem përgjigjuni në pyetjet 7, 8, dhe 9).

4. Sa jeni të kënaqur me trajtimin e çështjes nga gjykata?
 Mjaft i kënaqur
 Mesatarisht i kënaqur
 Nuk jam i kënaqur

- Neutral
5. Me çfarë problemi jeni ballafaquar gjatë zgjidhjes së rastit nga gjykatat në Kosovë?
- Kohëzgjatja e procedurës
 - Ndikimi i jashtëm në procedurën gjyqësore
 - Mungesa e eksperizës së gjyqtarëve në fusha më specifike
 - Asnjë problem
 - Të tjera
6. Cilat ishin arsyet (përparësitë) e përdorimit të gjykatës në vend të arbitrazhit?
7. Sa jeni të kënaqur me trajtimin e çështjes nga Qendra e Arbitrazhit?
- Mjaft i kënaqur
 - Mesatarisht i kënaqur
 - Nuk jam i kënaqur
 - Neutral
8. Me çfarë problemi jeni ballafaquar gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjes përmes arbitrazhit në Kosovë?
- Shpenzimet
 - Kohëzgjatja
 - Mungesa e procedurës së ankimimit
 - Asnjë
 - Të tjera
9. Cilat ishin arsyet (përparësitë) e përdorimit të arbitrazhit në vend të gjykatës?
10. Cilën metodë të zgjidhjes së mosmarrëveshjes do të preferonit në rast të ndonjë mosmarrëveshje të mundshme?
- Arbitrazhin
 - Gjykatat
11. Çfarë shihni si problem me gjykatat në Kosovë?
- Kohëzgjatja e procedurës
 - Ndikimi i jashtëm në procedurën gjyqësore
 - Mungesa e eksperizës së gjyqtarëve në fusha më specifike
 - Të tjera
12. Cilat do të ishin arsyet (përparësitë) e përdorimit të gjykatës në vend të arbitrazhit?
13. Çfarë shihni si problem në procedurën e arbitrazhit në Kosovë?
- Shpenzimet
 - Kohëzgjatja
 - Mungesa e procedurës së ankimimit
 - Asnjë
 - Të tjera
14. Cilat do të ishin arsyet (përparësitë) e përdorimit të arbitrazhit në vend të gjykatës?
15. Sa është i rëndësishëm konfidencialiteti për biznesin tuaj?
- Shumë
 - Mesatarisht
 - I parëndësishëm

- Varet nga situata

II. INFORMIMI NË LIDHJE ME ARBITRAZHIN

16. Sa keni njohuri për arbitrazhin dhe ndërmjetësimin?
- Po, jam i/e informuar
 - Jam pak i informuar
 - Jo, nuk jam i informuar
17. Nëse përgjigja juaj në pyetjen numër 16 është “Po, jam i/e informuar”, ju lutem spjegoni se përmes cilave burime jeni informuar?
18. Nëse përgjigja juaj në pyetjen numër 16 është “Jam pak i informuar” ose “Jo, nuk jam i informuar”, ju lutem spjegoni cilat janë arsyet e mosinformimit tuaj me arbitrazhin.

III. VENDIMARRJA NË RASTIN E PËRCAKTIMIT TË METODËS PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE

19. Sa përdorni kontratat e shkruara në biznes?
- Një të gjitha rastet
 - Vetëm në marrëveshjet e rëndësishme në biznes
 - Kryesisht biznesi funksionon me marrëveshje gojore
20. A aplikon biznesi juaj një politikë të brendshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?
- Po, politikë formale
 - Po, politikë joformale
 - Nuk kemi një politikë të tillë
21. Në kontratat tuaja a përdorni klauzolat e arbitrazhit/ndërmjetësimit?
- Po
 - Jo
 - Duke e konsideruar përfshirjen e tyre
22. A preferoni arbitrazhin në kontratat publike?
- Po
 - Jo
 - Nuk jam i sigurtë
23. A insiston biznesi juaj në përfshirjen e klauzolave të arbitrazhit?
- Po
 - Jo
 - Nuk jam i sigurtë
24. Brenda biznesit tuaj, kush merr vendimin përfundimtar lidhur me përfshirjen e klauzolave të arbitrazhit?
- Zyrtarët ligjor
 - Avokatët e jashtëm
 - Departamenti _____ brenda kompanisë
 - Bordi i Drejtorëve
 - Të tjera
25. Në afërsisht sa kontrata keni përfshirë klauzolat e arbitrazhit në periudhën 2012 - 2016?
- Më shumë se 50

- 10 – 50
- Më pak se 10
- Asnjë

IV. TJERA

26. A mendoni se Qendra e Arbitrazhit duhet të ofroj një mekanizëm apeli për vendimet?

- Po
- Jo

27. A mendoni se arbitrazhi është më i kushtueshëm se procedura gjyqësore?

- Po, në masë të vogël
- Po, shumë më i kushtueshëm
- Afërsisht njëjtë
- Kushton më pak

28. Sa keni besim në Qendrën e Arbitrazhit në Odën Ekonomike Amerikane?

- Shumë
- Mesatarisht
- Neutral
- Pak
- Nuk i besoj

Ju faleminderit për kohën!

